



Pranuar / Doretuar Emenduar / Prezentuar Received / Delivered	06.04.2022	2	viti god year
Organ / Institucija Organ / Institution	No. Prat / No. Pr. / Prat. No.	Shtypja Printig Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHTICK	1927/2022		1/5



Republika e Kosovës
 Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
 NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
 INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.162/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.162/2022 të datës 23.02.2022 të parashtruar nga ankuesja me adresë Prishtinë, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve në punë”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 06.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar ankesa me numër A.nr.162/2022 e datës 23.02.2022, e parashtruar nga ankuesja
- II. Ndryshohet Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 08.02.2022 lidhur me notën e përgjithshme të vlerësimit për ankuesen nga nota (2.91) në notën e përgjithshme mirë (3.36).
- III. Ky vendim zëvendëson formularin e vlerësimit të rezultateve në punë si në pikën II të dispozitivit dhe i njëjti të përfshihet në dosjen personale dhe regjistrat përkatës të nëpunëses civil.
- IV. Obligohet Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kundër Korrupsionit që të ndërmerret të gjitha veprimet e nevojshme administrative për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Ar sy e t i m

Ankuesja, sipas shkresave të lëndës e punësuar në Agjencinë Kundër Korrupsionit, e pa kënaqur me ri-vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021, më datë 23.02.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës kundër Formularit për Vlerësimin e Punës për vitin 2021 të datës 08.02.2022 me pretendimet ankimore së vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është në kundërshtim me gjendjen faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, me datë 28.02.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses në Agjencinë Kundër Korrupsionit, ndërsa kjo e fundit me datë 08.03.2022 përmes Njesisë së Burimeve Njerëzore, ka përcjellë dokumentacionin lidhur me këtë lëndë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankueses e datës 23.02.2022 me numër protokollit 964/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mailin zyrtar të datës 23.02.2022 dërguar nga ankuesja në Këshill; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2018 i datës 17.12.2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2019 i datës 08.01.2020; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2020 i datës 29.01.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021 i datës 31.01.2021; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punës për vitin 2021 i datës 08.02.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 28.02.2022 me numër prot:1046/2022; Përgjigjen në kërkesën të datës 08.03.2022 me numër prot: 1229/2022; Akt emërimit e ankueses të datës 14.02.2012 me numër 54/2012; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit i datës 04.12.2017 me numër prot:01-3966/17; Shkresën për përcaktimin e objektivave/detyrave të punës për vitin 2021 për ankuesen; Akt emërimit e i datës 06.05.2011 me numër prot:01-2676/11; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për i datës 20.02.2013; Ndryshimin dhe plotësimin e aktit të emërimit për i datës 20.02.2016; E-mailin e datës 09.03.2022 me provat e dërguara shtesë i protokolluar me numër:1257/2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar i lartë për parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Shef i Divizionit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Prokurimin Publik.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar provat materiale të çështjes në procedurë, ka konstatuar së ankesa e ankueses është *pjesërisht e bazuar, sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas ndryshimit dhe plotësimit të aktit të emërimit të datës 04.12.2017 mbanë pozitën "Zyrtare e Lartë për Parandalimin e Korrupsionit" në kuadër të Agjencisë Kundër Korrupsionit, ndërsa në bazë të formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me datë 31.01.2022 nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt është vlerësuar me notë të përgjithshme 2.42, ndërsa pas pakënaqësisë së ankueses i njëjti e ka ri-vlerësuar të njëjtën sipas formularit për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 me datë 08.02.2022 duke ia ngritur notën e përgjithshme nga 2.42 në 2.91.



Në bazë të shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur se ankuesja së bashku me udhëheqësen e drejtpërdrejtë e kanë nënshkruar formularin me përshkrimin e objektivave/detyrave të punës për vitin 2021 dhe ka konstatuar se objektivat e përcaktuara për vitin 2021 përputhen me objektivat për të cilat ankuesja është vlerësuar sipas formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të datës 31.01.2022 dhe atij të datës 08.02.2022.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankueses e cila pretendon se vlerësimi i bërë nga udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt nuk përkon me gjendjen faktike ngase i ka realizuar objektivat dhe detyrat e punës me numër 1 të përcaktuara për vitin 2021, ndërsa për objektivin numër 3 si dhe Udhëheqësi i Divizionit respektivisht udhëheqësi i saj i drejtpërdrejt nuk ka kërkuar asnjëherë përgjatë periudhës janar-dhjetor 2021 të marrë pjesë në ndonjë aktivitet të monitorimit të prokurimit, Këshilli përmes kërkesës për përgjigje në ankesë të datës 28.03.2022 përveç tjerash ka kërkuar, citoj: *"Dëshmi me shkrim nëse ndonjëherë gjatë vitit 2021 udhëheqësi i ankueses ka kërkuar performancë me të mirë, evitim të lëshimeve apo sygjërim në arritjen e objektivave"*, ndërsa përmes përgjigjes në kërkesë të datës 08.03.2022 dhe asaj të datës 09.03.2022 të pranuar nga Njësia e Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kundër Korrupsionit nuk është dëshmuar me fakte se udhëheqësi i drejtpërdrejt i ankues ndonjëherë gjatë vitit ka vepruar me qëllim të përmbushjes së obligimeve të përcaktuara me dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike neni 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 ku përcaktohet se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë për nëpunësin përbëhet prej fazave, si në vijim: 1.2 vlerësimin e progresit të arritur gjatë periudhës së vlerësimit, për realizimin e objektivave të përcaktuar"* nga rrjedh se në mungesë të veprimeve të ndërmarra me qëllim të përcjelljes së realizimit të objektivave gjatë vitit vlerësues përveç përcaktimit të objektivave në fillim të vitit dhe vlerësimit në përmbyllje të vitit kalendarik, Udhëheqësi i Drejtpërdrejt i ankueses ka vepruar në kundërshtim me nenin 3 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *"Vlerësimi i rezultateve në punë - nënkupton një proces të përhershëm që përfshin vlerësimin e realizimit të objektivave dhe vlerësimin e sjelljes profesionale të nëpunësit i cili realizohet në pajtim me nenin 43 dhe 71 të Ligjit Nr. 06/L - 114 për Zyrtarët Publikë si dhe në pajtim me këtë Rregullore"* si dhe në kundërshtim me nenin 7 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *"Mbikëqyrësi, së paku një herë gjatë periudhës vlerësuese dhe/ose sa herë që vlerëson të nevojshme, zhvillon takime me nëpunësin për të rishikuar progresin e bërë në arritjen e objektivave të përcaktuara dhe sjelljet profesionale si dhe për dhënien e sugjerime për përmirësime të nevojshme"*, andaj mbi këtë pikë pretendimi ankimor i ankues se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 ndërlydhur me objektivin numër 3 është bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike është i qëndrueshëm.

Kolegji ka analizuar përshkrimin e detyrave të punës për pozitën "Shef i Zyrës për Parandalimin e Konfliktit të Interesit dhe Korrupsionit", pozitë të cilën sipas akt emërimit të datës 06.05.2011 e mbanë udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses dhe ka gjetur se sipas pikës 5 të detyrave kryesore të punës është përgjegjëse për: *"Siguron përcjelljen e publikimeve të operatorëve ekonomik për aktivitetet e tyre në faqen e internetit të KRPP-së dhe publikimet e mediave për rastet e mundshme korruptive"* ndërsa sipas përshkrimit të detyrave të punës për pozitën të cilën e mbanë ankuesja "Zyrtar e Lartë për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik" sipas pikës 3 të detyrave kryesore të punës është përgjegjëse për: *"Në bashkëpunim me shefin e divizionit përcakton mënyrën e pjesëmarrjes së vëzhguesit në aktivitete të prokurimit publik"*, andaj mbi bazën e kësaj të gjeture Kolegji ka konstatuar se

vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 sipas formularit të datës 08.02.2022 me notën 1 për *"objektivin i përcaktuar me numër 3 -Monitorimi i aktivitetit të prokurimit"* është i pabazuar, i paqëndrueshëm dhe në kundërshtim edhe me përshkrimin e detyrave të tij të punës dhe obligimeve që rrjedhin nga rregullorja në fjalë, ngase udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankueses përveç që gjate vitit kalendarik 2021 nuk e ka konsultuar apo sugjeruar ankuesen asnjëherë lidhur me arritjen e objektivave e veçmas atij numër 3, i njëjti nuk ka përmbushur as detyrën e përcaktuar si në pikën 5 sipas përshkrimit të detyrave të tij të punës, ndërsa ankuesja sipas përshkrimit të detyrave të punës nuk mundet sipas detyrës zyrtare ta realizojë këtë objektiv për në bashkëpunim me shefin e divizionit, andaj Kolegji vlerëson se për këtë objektiv realisht nuk është dashur vlerësohet ankuesja, ndërsa i njëjti duhet të hiqet edhe nga formulari i vlerësimit për vitin 2021 me qëllim që i njëjti mos të përpjesëtohet ngase do ta ulte notën e përgjithshme të vlerësimit.

Kolegji, po ashtu ka analizuar vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2021 sipas formularit të datës 08.02.2022 dhe ka gjetur se ankuesja për objektivin numër 1 *"Parandalimi i shkeljeve ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit"* është vlerësuar me notë 2.80, ndërsa për objektivin numër 2 *"Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit përmes ofrimit të Opinioneve"* është vlerësuar me notë 3.75, andaj në kuptim të nenit 11 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 dhe 1.4 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike ku përcaktohet se: *"Objektivat dhe sjelljet profesionale do të vlerësohen me nota nga 1 deri në 5. Rezultati përfundimtar i vlerësimit llogaritet në bazë të mesatares së marrë dhe paraqitur si në vijim: Nga 2.5 deri më pak se 3.5 nënkupton "mirë"; Nga 3.5 deri më pak se 4.5 nënkupton "shumë mirë"* ndërlidhur me nenin 11 paragrafin 2 nën paragrafët 2.2 dhe 2.3 të së njëjtës rregullore ku përcaktohet se: *Kuptimi i notave si në paragrafin 1 të këtij neni është si në vijim: "Shumë mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili jo vetëm që ka realizuar të gjitha objektivat e punës, por ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit; "Mirë", vlerësohet nëpunësi, i cili ka realizuar të gjitha objektivat e punës, dhe ka treguar aftësi të pritshme të punës"* dhe ka vlerësuar se sipas këtyre vlerësimeve ankuesja i ka përmbushur të gjitha objektivat e përcaktuara të punës, respektivisht ka treguar gjithashtu aftësi të punës që tejkalojnë pritjet si dhe ka kontribuar në realizimin e objektivave dhe performancën e përgjithshme të institucionit referuar objektivit numër 2 dhe realisht ky vlerësim përputhet edhe me pretendimet ankueses si në ankesën e datës 23.02.2022 e cila pretendon se i ka arritur të gjitha objektivat, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se vlerësimi i rezultanteve në punë për objektivat e punës të përcaktuara në numrin rendor 1 *"Parandalimi i shkeljeve ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit"* dhe atij me numër rendor 2 *Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit përmes ofrimit të Opinioneve"* është i qëndrueshëm dhe i bazuar, ndërsa ankuesja pretendimin e saj nuk e ka mbështetur me fakte dhe prova të mjaftueshme se pse është dashur të vlerësohet ndryshe.

Kolegji pas administrimit provave të ofruara nga palët në procedurë, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses si dhe pas analizimit të dispozitave të aplikuara ligjore për rastin konkrete, ka vërtetuar se ankesa e ankueses e datës 23.02.2022 është pjesërisht si e bazuar. Në kuptim të kësaj si dhe arsytimit të pasqyruar si më lartë në këtë vendim, pretendimi ankimor i ankueses ndërlidhur me vlerësimin për objektivin numër 3 *"Monitorimi i aktivitetit të prokurimit"* është i bazuar, ndërsa pretendimet ankimore të ankueses ndërlidhur me objektivat e punës të përcaktuara në numrin rendor 1 *"Parandalimi i shkeljeve ligjore me elemente korruptive në aktivitetet e prokurimit"* dhe atij me numër rendor 2 *"Përmirësimi i aktiviteteve të prokurimit përmes ofrimit të Opinioneve"* janë të pabazuara dhe si të tilla refuzohen.

Nisur si me lartë, si dhe duke u bazuar në nenin 13 paragrafi 4 të Rregullores Nr. 21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike, ku përcaktohet se: "Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil pas pranimit të ankesës, në afatin ligjor, vendos duke miratuar apo ndryshuar vlerësimin e mbikëqyrësit (vlerësuesit)", Kolegji ka konstatuar se mbi bazën e të gjeturave dhe vlerësimeve si më lart, ka ndryshuar Formularin e Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2021 të datës 08.02.2022, për ankuesen ashtu që nota e përgjithshme përfundimtare dy pikë nëntëdhjetenjë (2.91), ndryshohet me notën e përgjithshme përfundimtare tre pikë tridhjetegjashtë (3.36), ndërsa Kolegji deri te ky vlerësim ka ardhur si përfundim i asaj që u potencuar si më lartë, se objektivin numër 3 e kemi eliminuar nga formulari i vlerësimit e pastaj ndryshimi i vlerësimit është përshtatur në kuptim të nenit 10 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Po ashtu, Njësia e Burimeve Njerëzore e Agjencisë Kundër Korrupsionit duhet të kujdeset që vendimi i Këshillit të vendoset në dosjen personale të ankueses në pjesën ku mbahet regjistri i vlerësimeve të rezultateve në punë.

Andaj, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.162/2022

Flakron Gashi

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet

- Ankueses
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kundër Korrupsionit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.